



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:273645
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05512313

C-IV-17-0091

Parashtruesja e ankesës; S A B nga Prishtina, të cilën e përfaqëson sipas me shkrim autorizimit avokati H P, nga Prishtina.

E paditura; Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha nr.55, Lakrishte-Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi me datën; 27.03.2024, merr këtë;

A K T V E N D I M

Ankesa e parashtruar nga S A B nga Prishtina, konsiderohet e tërhjekur për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

Rrethanat faktike dhe procedurale;

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit me datën; 05.01.2024, ka hartuar me shkrim vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për parashtruesen e ankesës duke e detyruar të njëjtën që pagesën ta kryej në afatin kohor prej 15 ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të kësaj vërejtje. Në shkresat e lëndës rezulton se i autorizuari i parashtrueses së ankesës e ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore me datën; 15.01.2024, mirëpo edhe përkundër faktit të pranimit vërejtjes në shkresat e lëndës nuk është dëshmia se është kryer pagesa.

Arsyetimi ligjor;

Dhoma e Posaçme e Gjykata Supreme e Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit duke iu referuar shkresave të lëndës ka konstatuar se i autorizuari i parashtrueses së ankesës edhe përkundër faktit që ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore me datën; 15.01.2024, nuk e ka paguar taksën gjyqësore në afatin kohor prej 15 ditëve.

Andaj gjykata duke iu referuar dispozitës së nenit 253 paragrafi 5 të LPK-së ka vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike;

Ndaj këtij aktvendimi parashtruesi i ankesës mund të ushtroj ankesë me shkrim duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në afatin kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke llogaritur nga data e pranimin të këtij aktvendimi.

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi